

## **MINUTAT E TAKIMIT TË GRUPIT TË KONTAKTIT TË TREGUT BANKAR**

### **6 TETOR 2016**

Në vijim të krijimit të Grupit të Kontaktit të Tregut Bankar (GKTB) midis drejtuesve të departamenteve të thesarit të të gjitha bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë (BSH) me fokus përmirësimin e tregjeve financiare, në datën 6 tetor 2016 u organizua në mjediset e BSH mbledhja e parë zyrtare e këtij Grupi. Takimi u drejtua nga drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare (DOM), z. Marian Gjermani. Me ftesë të DOM, në këtë mbledhje ishin të pranishëm edhe Këshilltari i FMN-së pranë BSH-së, z. Guido Della Valle, si dhe përfaqësues të tjerë nga DOM dhe Ministria e Financave (MF).

Fjala përshëndetëse u mbajt nga z. Gjermani, i cili prezantoi rendin e tematikave të mbledhjes sipas programit të paracaktuar. Fillimisht, mbledhja nisi me diskutimet e pjesëmarrësve mbi përlogaritjen e normave fikse në tregun ndërbankar dhe nevojën e rregullimit të këtij procesi. Më tej, fjalën e mori z. Della Valle për të diskutuar me përfaqësuesit e bankave rëndësinë e zhvillimit të tregut të parasë dhe hapat për zhvillimin e tij, si dhe për t'i njohur ata me përgjigjet e pyetësorit që iu dërgua bankave nga DOM mbi aktivitetin e tregjeve financiare në vendin tonë. Tema e fundit për diskutim i referohej kontratës së unifikuar për marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjella të riblerjes.

**Tema: Normat fikse të tregut ndërbankar (TRIBID/TRIBOR)**  
**Prezantuar: Z. Marian Gjermani, Drejtor, DOM**

Diskutimi për normat fikse në tregun ndërbankar të përlogaritura nga BSH, si TRIBID e TRIBOR, nisi me shprehjen e shqetësimit të BSH për mënyrën e vendosjes së kuotimeve të bankave tregtare për efekt përlogaritjeje të TRIBID dhe TRIBOR. Pavarësisht shqetësimit deri tani nuk ka pasur konstatime rreziku. Me qëllim parandalimin nga rreziqe potenciale të lidhura me këto norma, z. Gjermani u kërkoi bankave administrim më të mirë të procesit duke saktësuar dhe formalizuar ligjërisht procedurat e brendshme për përcaktimin e kuotimeve të tyre.

Në diskutimet vijuese, u ra dakord mbi nevojën e vazhdimësisë së përdorimit të normës TRIBOR, e cila ndër të tjera përdoret si referencë për një numër të madh kontratash kredihënieje të bankave me klientët. Në përfundim, u vendos ngritja e një grupi pune për hartimin e një dokumenti, ku të cilësohen shprehimisht procedurat e ndjekura për përcaktimin e kuotimeve të bankave.

**Tema: Hapat për zhvillimin e tregjeve financiare dhe përgjigjet e pyetësorit**  
**Prezantuar: Guido Della Valle, Këshilltar i FMN-së pranë BSH-së**

Duke sjellë në vëmendje të pjesëmarrësve rëndësinë e mirëfunksionimit të tregjeve financiare, prezantimi synoi identifikimin e hapave konkretë që priten të kenë ndikimin më të madh në zhvillimin e tregjeve, për t'u analizuar më tej me propozime konkrete në takimet vijuese të Grupit. Rëndësia e tregjeve u konsiderua si nga perspektiva e bankave të nivelit të dytë edhe nga perspektiva e BSH-së dhe Ministrisë së Financave, duke u dakorduar që për

të tre palët promovimi i tregjeve do të jetë i dobishëm. Në këtë kuadër, z. Della Valle përmendi si përparësi të zhvillimit të tregut të parasë menaxhimin më efikas të likuiditetit, stabilitetin financiar dhe lehtësimin e huamarrjes, uljen e kostove të ndërmjetësimit, si dhe përmirësimin e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Zhvillimi i tregut sekondar, nga ana tjetër, do të reduktonte rrezikun e likuiditetit dhe kostot e financimit të qeverisë, dhe do të ndihmonte BSH-në në menaxhimin e deficitit të sistemit bankar.

Situata aktuale e tregjeve në Shqipëri u analizua më konkretisht në kontekst edhe të zhvillimeve globale për sa u përket ndryshimeve rregullative ndërkombëtare që kanë penalizuar aktivitetin në tregun ndërbankar dhe kanë shtuar perceptimin e rrezikut. **U përmend se ekziston potenciali për zhvillimin e disa segmenteve të tregjeve, por u theksua se iniciativat janë më efikase kur propozohen nga vetë pjesëmarrësit e tregut dhe roli i bankës qendrore të jetë ai i përshejtuesit.** Pyetëtori tregoi se ka potencial për rritje të tregtimit në tregun ndërbankar të kolateralizuar dhe tregun sekondar të letrave me vlerë.

Më tej, z. Della Valle njohu bankat me rezultatet e pyetësit, dërguar bankave nga BSH mbi aktivitetin e tregjeve financiare në vendin tonë. Rezultatet reflektojnë këndvështrimin e 12 bankave që iu përgjigjën pyetësit dhe sugjerojnë pritjen e tyre për rritje të segmentit të kolateralizuar të tregut të parasë kundrejt potencialit të limituar të atij të pakolateralizuar nëpërmjet optimizimit të limiteve të tregtimit dhe përmirësimit të profileve të likuiditetit. Sipas përgjigjeve të pyetësit, potenciali për rritje ekziston edhe në tregun sekondar të letrave me vlerë të qeverisë nëse zgjidhet mungesa e “*market makers*”, shtohen emetimet me maturime afatgjata, dhe ngushtohet hendeku kërkesë-ofertë. Paralelisht, u listuan edhe disa alternativa potenciale të renditura si prioritete më herët nga bankat në pyetësor.

Në përfundim të diskutimeve mbi këto alternativa, u sugjerua një analizë më e detajuar mbi to nga ana e bankave për t'u diskutuar, bashkë me BSH-në dhe MF-në, në mbledhjen e radhës.

<b>Tema:</b>	<b>Kontrata e unifikuar për marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjella të riblerjes</b>
<b>Prezantuar:</b>	<b>Suela Totokoçi, Intesa Sanpaolo Bank</b>

Prezantimi i zj. Totokoçi trajtoi synimin për të unifikuar kontratën për marrëveshjet e riblerjes (*REPO*) dhe të anasjella të riblerjes (*REVERSE REPO*) midis bankave tregtare, me qëllim përfundimtar lehtësimin e këtyre veprimeve e rrjedhimisht ndikimin pozitiv në zhvillimin e tregut ndërbankar. Aktualisht, rastet e kryerjes së *REPO/REVERSE REPO* mes bankave nuk janë të shpeshta.

Bankat u shprehën se janë të gatshme të nisin procedurat për unifikimin e një kontrate tip për t'u përdorur lehtësisht e gjerësisht. Në realizim të kësaj, u ngrit një grup pune që do të sigurojë konceptimin e një formati konkret të kësaj kontrate.